

KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(Lloji kuota)

Sot me date 11.03.**2019** ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate si me poshte vijon:

PALA shitëse:

- Z. Fatos Jaupi**, i biri i Jake, i datëlindjes 28.06.1965, lindur ne Berat dhe banues ne Tiranë, madhor dhe me zotesi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. 024444556 dhe me numer personal G50628084E në cilesine e ortakut të vetem të shoqërisë Viola Green

PALA blerëse:

- Z. Marsel Shega**, i biri i Mahmud, i datëlindjes 17.04.1973, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotesi të plotë per të vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit Nr. 032975693 me numer personal H30417017J ne cilesinë e ortakut të vetem të shoqërisë Viola Green.

Të përgjithshme

- Shitesi është zotërues i 1(një) kuote, me vlere 34.000 (*Tridhjetë e katër mijë*) Lekë, qe përbën **34 (tridhjetë e katër)** % të kapitalit të Shoqërisë "**Viola Green**" shpk, me seli ne TIRANE, _____. (më poshtë referuar si shoqëria.)
- Shoqëria është rregjistruar pranë QKR-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e pajisur me **NUIS L51928004K** me objekt kryesor:
"*Te Ushtrrojë aktivitetet privat ne fushen e sherbimeve grumbullimin, seleksionim, perpunim, I mbajtjeve urbane, pastrimit te mbeturinave urbane, perpunimi i tyre, import - eksport i pajisjeve, makinerive ne funksion te aktivitetit dhe makineri e pajisje te tjera, linja perpunimi, prodhimi te ndryshme.* _____".
- Kapitali i shoqërisë është **100 000,00 (Njëqind Mijë)** lekë.
- Shoqëria "**Viola Green**" Sh.p.k zotërohet nga 3 ortakë:
 - Z. Fatos Jaupi i cili zoteron 34(tridhjetë e katër) kuota qe perbejne 34% te kapitalit themeltar.
 - Z. Marsel Shega, i cili zotëron 33(tridhjetë e tre) kuota qe perbejne 33% te kapitalit themeltar.
 - Z. Avni Hysa, i cili zotëron 33(tridhjetë e tre) kuota qe perbejne 33% te kapitalit themeltar.

Neni 1

Objekti

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, Shitesi i kalon bleresit --- 1--- % të kapitalit të zotëruar në kete shoqëri.

Neni 2

Kalimi i pronësisë mbi kuotat

Menjëherë me nënshkrimin e kontratës shitësi Fatos Jaupi zotëron 33% të kapitalit dhe blerësi Marsel Shega zotëron 34% të kapitalit .

Neni 3

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 4

Regjistrimi

- Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë QKR-së në bazë të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria “ **Viola Green** ” Sh.p.k do të ketë 3 ortakë:

Z. Avni Hysa , zotërues i 33 kuote

Z. Fatos Jaupi , zotërues i 33 kuote

Z. Marsel Shega , zotërues i 34 kuote

- Personi që kalon kuotat dhe ai që i fiton ato, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, nga Çasti i kalimit të kuotave deri në Çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

Neni 5

Shpenzimet

Të gjitha taksat, tatimet si dhe shpenzimet që kanë lidhje me këtë kontratë do të paguhen nga pala përkatëse sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar. Palët në këtë kontratë nuk mund ti kërkojnë njëra tjetrës uljen/ngritjen e çmimit të shitjes për shkak të shpenzimeve të sipërpëmendura.

Neni 6

Interpretimi i Kontratës

Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 7

Njoftimi zyrtar midis palëve

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim ndërmje palëve do të bëhet në formë të shkruar dhe në adresat e përshkruara në këtë kontratë.

Neni 8

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jete *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane*.

Neni 9

Hartimi i Kontratës

Kjo kontratë hartohet në kater njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga 3 njësi i mbajnë palët dhe një njësi depozitohet pranë QKR-së .

Ne Palët deklarojme se kuptojme dhe se e pranojnë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin tone të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajmë atë rregullisht.

PALET KONTRAKTUESE

Shitësi

-----*Fatos Jaupi*-----

Fatos Jaupi

Blerësi

-----*Marsel Shega*-----

